



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE**

V E N D I M

Nr.23 Datë 15/04/2024

Trupa e vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Arben Sefaj	Kryesues
Denisa Sina	Relator
Suela Bulku	Anëtar

Asistuar nga anëtarja e Sekretariatit Teknik, Ledjana Azemaj, më datë 12.04.2024, ora 08:00, në Tiranë, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore çështjen që i përket:

SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT: **Z.Ermal Petrit Muçaj**, me funksion Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

Rregullore nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AMP-së

Pasi dëgjoi gjetjet, bazuar në arsyetimin ligjor si dhe rekomandimin e relatores së çështjes Denisa Sina vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit; pasi dëgjoi subjektin e vlerësimit Ermal Muçaj i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Ligjit nr.12/2018 të ndryshuar,

VËREN:

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore në vazhdim (AMP), është organi kompetent që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Agjencisë Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 05.04.2023 si “Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, në DPPSH.
2. Subjekti i vlerësimit, **Ermal Muçaj**, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar në datën 05.04.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.7 datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”.
3. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin (nr.1, datë 18.04.2023) u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: Znj.Denisa Sina (Relator), Z. Arben Sefaj (Kryesues) dhe Znj. Suela Bulku (Anëtare).
4. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197 datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin (nr.1, datë 18.04.2023) vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Ermal Muçaj
5. Relatori i çështjes, Znj.Denisa Sina nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 18.04.2023 ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
6. Më datë 19.04.2023 janë dërguar formularët e administruar nga ana e relatorit e konkretisht:

- ✓ Me shkresën me nr.** prot datë 19.04.2023 është dërguar formulari i deklaramit të pasurisë pranë ILDKPKI
 - ✓ Me shkresën me nr. ** prot datë 19.04.2023 është dërguar formulari i deklaramit të aftësive profesionale.
 - ✓ Me shkresën me nr. ** prot datë 19.04.2023 është dërguar formulari mbi deklaratën e kontrollit të figurës.
7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore në datën 19.04.2023 duke shprehur nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
 8. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
 9. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
 10. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:

-  vlerësimin e pasurisë;
-  kontrollin e figurës;
-  vlerësimin e aftësive profesionale.

11. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
 - a. Ligji 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
 - b. Ligji nr.128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”
 - c. Ligji nr.40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”
 - d. Ligji nr.9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”
 - e. Udhëzim i Ministrit të Brendshëm Nr.7 datë 17.01.2023 “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”.
 - f. Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe ILDKPKI nr. 15 datë 27.01.2023 “Për miratimin e formularëve të deklaramit të Pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme’ i ndryshuar
 - g. Rregulloren nr.197 datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”

Gjithashtu trupa e vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

- + Deklarata e Pasurisë,
- + Deklarata për Kontrollin e Figurës,
- + Formulari i Vlerësimit Profesional
- + Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklarinimet,
- + Raportin e Vlerësimit të Pasurisë nga ILDKPKI
- + Raportin e Vlerësimit të Figurës nga AMP
- + Raportin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale nga DPPSH
- + Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.
- + provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.
- + ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.

12. Trupa e vlerësimit, më datë 09.04.2024 pasi dëgjoi relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Ermal Muçaj, me Vendimin nr. 3 datë 09.04.2024, vendosi;

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - + Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;
 - + Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;
- c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

13. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 34, pika 1, e Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

14. Në datën 11.04.2024, Trupa e Vlerësimit nëpërmjet kryesuesit të seancës, njoftoi subjektin e vlerësimit për mbajtjen e seancës dëgjimore në datën 12 Prill, ora 08:00, në ambjentet e Ministrisë së Brendshme në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit nr.12/2018 (i ndryshuar).

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit Ermal Muçaj u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si dhe Kodin e Procedurave Administrative.
16. Subjekti i vlerësimit nuk kishte zgjedhur mbrojtës ligjor. Gjatë seancës dëgjimore, pas fjalës së relatorit, subjekti i vlerësimit parashtroi disa shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e vlerësimit në tërësi të kryer ndaj tij (të regjistruar në materialin audio në seancë dëgjimore). Në fund të seancës dëgjimore datë 12.04.2024, subjekti i vlerësimit Ermal Muçaj, kërkoi konfirmimin në detyrë dhe Trupa e Vlerësimit shpalli vendimin në datë 15.04.2024.

II. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

17. Subjekti i vlerësimit, Z. Ermal Petrit Muçaj ka qenë bashkëpunues dhe korrekt gjatë gjithë procesit të vlerësimit në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të Ligjit të Vlerësimit nr.12/2018 (i ndryshuar);
18. Subjekti ka paraqitur që në fazën e dorëzimit të deklaratave edhe dokumentacion shoqërues të vlerësuar nga ana e tij, si dhe gjatë fazës së hetimit administrativ, gjatë komunikimit dhe pyetjeve të drejtuara nga relatori, është përgjigjur dhe ka përcjellë dokumentacion shoqërues/justifikues shtesë, me qëllim vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, sipas rastit dhe rrethanave të tjera të çështjes për sqarim, i kërkuar nga ana e relatorit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

19. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
20. Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 09.03.2023. Formulari i Pasurisë mban nr. **x index 03.03. 2023**.
21. Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33 ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.
22. **Trupa e vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:**
 - deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
 - raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
 - provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;

- dokumentacionin e paraqitur në deklarinimet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike
23. Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklarinimet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34, shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.
24. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
25. Hetimi administrativ konsistoi në:
- ✚ verifikimin e vërtetësisë së deklarinimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
 - ✚ verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
 - ✚ evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
 - ✚ evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarinimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.
26. ILDKPKI-ja, në përputhje me Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit **Z. Ermal Petrit Muçaj**.

A) I. DEKLARATA E PASURISË

27. Në zbatim të nenit 32, të Ligjit nr. 12/2018, subjekti i vlerësimit i nënshtrohet procesit të vlerësimit kalimtar për periudhën e vlerësimit të deklaratës së pasurisë nga data e fillimit të marrëdhënies së punës në institucionin përkatës, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarinimit të pasurisë. Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si më poshtë vijon:

Pasuria nr.1.Apartament banimi me sip. 136 m², nr. pas. ***, rruga ***, Tiranë, blerë në shumën 61.200 euro, sipas kontratës së shitjes nr.***, datë 30.09.2011.

Burimi i krijimit: Kredia në shumën 45.000 euro në RFZ Bank. Gjithashtu si burim ka shërbyer dhe vlera e llogaritur për kthimin de facto të apartamentit me sip. 81 m², shoqërisë së ndërtimit,

të cilin e kishte blerë me parë në shumën 2.000.000 lekë, (apartament i cili është shitur me prokurë për llogari të shoqërisë së ndërtimit).

28. Trupa e vlerësimit për vërtetimin e faktit administroi:

- ✚ Kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.09.2011, me palë shitëse shoqëria "*****" shpk, dhe blerës Ermal Muçaj, me objekt shitjen e një apartamenti me nr. pasurie ***, zk. ***, me sip. 136 m², ndodhur në rrugën "*****", Tiranë dhe çmimi i shitjes së këtij apartamenti është në vlerën 61.200 euro, pagesë e cila është bërë jashtë zyrës noteriale.

29. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara, mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, ILDKPKI dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, u kanë kërkuar informacion Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Regjistrat Noterial, FSHU, 14 Shoqërive Rajonale Ujësjiellës – Kanalizime, institucioneve bankare dhe jo-bankare, si dhe u janë drejtuar vetë subjektit. Nga përgjigjet e administruara dhe të analizuara, rezultoi se:

- ✚ ASHK Tiranë - DV Tirana Rurale 1, DV Tiranë Rurale 2, DV Tirana Veri, DV Tirana Jug, me shkresat nr. *** prot., dt. 07.07.2023, dt. 23.06.2023, dt. 26.06.2023, dhe (e-mail), nuk konfirmojnë pasuri në emër të subjektit Ermal Muçaj dhe personave të lidhur.
- ✚ ASHK Online, nuk konfirmon pasuri të regjistruar në emër të subjektit apo personave të lidhur.
- ✚ Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** prot, datë 08.05.2023, ka bashkëlidhur CD të llogarive bankare të Ermal Muçaj, ku konfirmohet kredia e disbursuar në datën 24.12.2010, në vlerën 45.000 euro. Në të njëjtën datë transferohet vlera 44.745 euro nga Ermal Muçaj, në favor të P.O, me përshkrimin "Kalim për blerje apartamenti, sipas kontratës nr. *** rep., *** kol.
- ✚ Abi Bank, me shkresën nr.*** prot, datë 08.05.2023, konfirmon se Ermal Muçaj, ka marrë kredi hipotekore në datë 16.05.2006, në vlerën 25.000 euro, me afat maturimi 20 vjeçar, vlerë e cila është transferuar në të njëjtën datë.
- ✚ Nga QKB janë shkarkuar:
 - Ekstrakt historik i shoqërisë "*****" shpk, datë 02.11.2023, me Nipt.***, themeluar në datë 29.04.2002, me administrator dhe ortak të vetëm shtetasin A.L, *me status shoqëri në likuidim e sipër.*
 - Ekstrakt historik i shoqërisë "*****" shpk, datë 02.11.2023, me Nipt. ***, themeluar në datë 05.12.2004, me ortak të vetëm shtetasin A.L.

30. Bashkëlidhur deklaratës u administrua:

- ✚ Kontratë sipërmarrje për ndërtim apartamenti, datë 23.5.2005, me palë porositësve Ermal Muçaj, Benarda Muçaj dhe sipërmarrës shoqëria *** shpk, përfaqësuar nga ortakët dhe administrator A.L, me objekt ndërtimin e një apartamenti me sip. 86 m², së bashku me sipërfaqen e shkalleve, e ndodhur në Tiranë, rruga "*****", në vlerën 43.000 euro. Kësti i parë, prej 10.000 euro, është likuiduar menjëherë në momentin e nënshkrimit të kontratës. Kësti i dytë, prej 33.000 euro, do të paguhet kur të aplikohet kredia nga banka.
- ✚ Leje ndërtimi nga KRRT Bashkia Tiranë, nr. *** prot, datë 23.12.2004, me subjekt ndërtues shoqëria ***, për godinë banimi dhe shërbime, në rrugën "Irfan Tomini", në pronësi të S.D dhe D.H.
- ✚ Shkresë nga Abi Bank, nr. *** prot, datë 28.04.2022, që konfirmon kredinë e disbursuar në llogari të Ermal Muçaj, në datë 16.5.2006, në vlerën 25.000 euro, ku në të njëjtën datë

- transferohet vlere 24.700 euro, me përshkrimin "Blerje apartamenti, Sip. Kont. Sipërm. dt. 23.05.05, nga Ermal, Benarda Muçaj, në favor të *** shpk".
- ✚ Vërtetim nga dokumenti hipotekor, datë 18.07.2007, për pasurinë me nr****, me sipërfaqe 81 m2, në emër të S.D.
 - ✚ Kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.08.2007, me palë shitëse S.D dhe blerës Ermal Muçaj, me objekt shitblerjen e një apartamenti me numër pasurie ****, me sipërfaqe banimi 81 m2, e ndodhur në rrugën "****", Tiranë, në vlerën 2.000.000 lekë, vlerë e cila është likuiduar përpara hartimit të kësaj kontratë.
 - ✚ Vërtetim nga dokumenti hipotekor, datë 07.11.2011, ku vërteton se në regjistrin hipotekor datë 11.09.2007, figuron e regjistruar pasuria me nr. ****, zk. 8260, me sip. 81 m2, ndodhur ne rrugën ****, Tiranë, në emër të Ermal Muçaj.
 - ✚ Kontratë prenotimi dhe dorëzimi i dy apartamenteve, nr. *** rep, nr. *** kol, datë 30.11.2010, me palë, të porositurit P. dhe K. Osmenej, dhe palë porositësve Ermal Muçaj, me objekt prenotimi dhe dorëzimi, të dy apartamenteve, kati i pestë teknik, me sipërfaqe të përgjithshme 92 m2 dhe 63.1 m2. Këto apartamente, pala e porositur P. dhe K. Osmenej, i kanë përfituar në cilësinë e pronarëve të truallit të vënë në dispozicion shoqërisë "****" shpk, për ndërtim godinë banimi, në rrugën "I.T", Tiranë. Çmimi i shitjes, për dy apartamentet e sipërcituara, është në vlerën 90.000 euro. Kësti i parë prej 60.000 euro, do të paguhet pas lëvrimit të kredisë, nga Raiffeisen Bank, brenda muajit Dhjetor 2010, dhe kësti i dytë prej 30.000 eurosh, do të paguhet kur të realizohet kontrata e shitblerjes.
 - ✚ Kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.09.2011, me palë shitëse shoqëria "****" shpk, përfaqësuar nga ortaku, ai dhe administrator A.L, dhe palë blerëse Ermal Muçaj, me objekt shitjen e apartamentit me numër pasurie **** zk. 8260, me sip. banimi 136 m2 + 12.5 m², sipërfaqe e përbashkët, në katin e pestë, ndodhur në rrugën "****", Tiranë, në vlerën 61.200 euro, vlerë e cila është shlyer jashtë zyrës noteriale.
 - ✚ Prokurë e posaçme, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.09.2011, me palë Ermal Muçaj dhe Benarda Muçaj, të cilët emërojnë si përfaqësues të posaçëm shtetasin A.L, të cilit i japin kompetencë të plotë që t'i përfaqësojë në ZVRPP Tiranë, për të aplikuar për kartelën e pasurisë të llojit apartament, me nr. ****, zk. ****, me sip. 81 m², e ndodhur në rrugën "I.T", Tiranë. Ti përfaqësojë para zyrave të noterisë Tiranë, për shitjen e këtij apartamenti, duke nënshkruar kontratën e shitjes në emrin e tyre, duke përcaktuar çmimin e shitjes, dhe të marrë shumën e parave nga kjo shitje, si dhe ti përfaqësojë në pagesat e detyrimeve tatimore, nga të ardhurat e përfituara nga kjo shitje.
 - ✚ Vërtetim nga dokumenti hipotekor, datë 13.10.2011, për pasurinë me nr. **** zk. ****, e ndodhur në rrugën "****", Tiranë, në emër të Ermal Muçaj.
 - ✚ Kontratë shitje nr.*** rep, nr.*** kol, datë 02.11.2012, me palë shitëse Ermal dhe Benarda Muçaj, përfaqësuar me prokurë nga A.L, dhe blerës Drita Sopoti dhe Suzana Alidervishi, për pasurinë me nr. ****, e llojit apartament, ndodhur në rrugën "I.T", Tiranë, me sip. 81 m2, në vlerën 7.128.000 lekë, çmim i shlyer tërësisht nga blerësi.
31. Në proces-verbalin e datës 18.10.2023, subjekti ka sqaruar se ai dhe bashkëshortja disponojnë vetëm një apartament banimi, me sip. 136 m2, ndodhur në rrugën "****", Tiranë, të cilin e ka deklaruar, ku jeton me familjen e tij. Burimi i këtij apartamenti, është nga kredia bankare në vlerën 45.000 euro, pranë Raiffeisen Bank, në vitin 2010, si dhe apartamenti i mëparshëm me sip. 81 m2, dhënë shoqërisë së ndërtimit "****" shpk., në vitin 2011, nëpërmjet prokurës administratorit të saj, A.L. Veprimet e kryera nga ana e tij, në lidhje me

kontratat e cituara më sipër, janë kryer pa patur njohuritë e duhura ligjore në atë periudhë.

32. Me inventarin e datës 06.11.2023, subjekti ka dorëzuar dokumentacionin, si më poshtë:

- *Deklaratë e thjeshtë, nga shtetasi A.L, datë 03.11.2023, i cili deklaron se është përfaqësues ligjor, si dhe ortak i vetëm në shoqërinë “****” shpk, me Nipt K216300020. Shoqëria *** shpk, ka ndërtuar një objekt, godinë banimi dhe shërbime, sipas lejes së ndërtimit miratuar nga KRRT Bashkia Tiranë, nr. 12022 prot., datë 23.12.2004, ndodhur ne rrugën "I.T", Tiranë, mbi truallin e vënë në dispozicion, në pronësi te S.D dhe D.H. Referuar dokumentacionit përkatës, sqaron se ne datën 23.05.2005, shoqëria “****” shpk, ka lidhur një kontratë sipërmarrje për ndërtim apartamenti, me sip. 86 m², e ndodhur në Tirane, ne rrugën "Irfan Tomini", me shtetasin Ermal Muçaj, në vlerën e parashikuar ne kontrate prej 43.000 euro. Gjithashtu referuar dokumentacionit, rezulton se vera e paguar nga Ermal Muçaj për këtë apartament ka qenë në total rreth 35.000 euro, nga të cilat 10.000 euro cash, me lidhjen e kontratës në vitin 2005, dhe 25.000 euro me transaksion bankar në muajin Maj të vitit 2006. Deklaruesi sqaron se kontrata e sipërmarrjes u nënshkrua me shoqërinë “****” shpk, por në përfundim të ndërtimit, ky apartament i takoi shtetasit S.D, si pronar trualli, me të cilin janë bërë edhe likuidimet financiare, sipas marrëveshjeve që shoqëria kishte me këtë shtetas, si dhe për pasuri te tjera në vijim, ndërmjet tij si pronar trualli dhe shoqërisë ndërtuese. Kjo vërtetohet edhe nga fakti që ky apartament me sipërfaqe 81 m² është regjistruar dhe hipotekuar në emër te S.D, ne vitin 2007, i cili me kontratë shitblerje ia shet shtetasit Ermal Muçaj, me vlerën e dakortësuar, për të cilën shoqëria nuk kishte pretendime të tjera për këtë pasuri, duke u likuiduar totalisht.*
- *Deklaratë e thjeshtë nga shtetasi S.D, datë 30.10.2023, i cili deklaron se shoqëria *** shpk, ka ndërtuar një objekt, godinë banimi dhe shërbime, sipas lejes së ndërtimit miratuar nga KRRT Bashkia Tiranë, ne vitin 2004, ne rrugën "Irfan Tomini", Tiranë, ne pronën e tij dhe të Dervish Hysenbelliu, ku ka përfutuar disa pasuri. Sqaron se në vijim, shtetasi Ermal Muçaj, me të cilin ka patur marrëdhënie shoqërore, ka blerë një apartament banimi me sipërfaqe totale neto prej 81 m², ne vitin 2005. Kontrata e sipërmarrjes për këtë apartament është lidhur ne këtë vit me firmën ndërtuese, shoqërinë *** shpk dhe pagesat janë kryer ne favor të firmës ndërtuese në vlerën 35.000 euro në total. Sqaron se ky apartament, sipas marrëveshjeve që kishte me shoqërinë ndërtuese ne atë periudhë, ne përfundim të ndërtimit te objektit i takoi atij, si pronar trualli. Për këtë arsye, në vitin 2007, u regjistrua dhe u hipotekua, në emrin e tij dhe në muajin gusht 2007 është përpiluar kontrata përfundimtare e shitjes mes deklaruesit dhe Ermal Muçajt. Ne këto kushte ka rënë dakord, që pavarësisht vlerës së kontratës së sipërmarrjes te përcaktuar, prej 43.000 euro, Ermali të paguante vetëm vlerën totale prej 35.000 euro, kjo me dakortësinë e te gjitha palëve të përfshira (deklaruesi, Ermal Muçaj dhe shoqëria ndërtuese), duke u shlyer totalisht mes tyre. Sqaron se Ermal Muçaj e ka shlyer tërësisht detyrimin me vlerën e mësipërme, pavarësisht vlerës së kontratës së shitblerjes përfundimtare. Deklaruesi sqaron se me shoqërinë ndërtuese janë likuiduar ne lidhje me pagesën e kryer nga Ermali, pasi me këtë shoqëri kishin edhe marrëdhënie të tjera, në lidhje me pasuri te tjera në vijim në këtë objekt.*
- *Deklaratë e thjeshtë nga shtetasit P. dhe K. Osmenej, date 3.10.2023, te cilët deklarojnë se shoqëria *** shpk, ka ndërtuar një objekt, godinë banimi dhe shërbime, sipas lejes së ndërtimit miratuar nga KRRT Bashkia Tiranë, ne vitin 2005, ndodhur në rrugën Irfan Tomini, Tiranë, në truallin e vënë në dispozicion në pronësinë e tyre. Nga kjo marrëveshje me shoqërinë ndërtuese kanë përfutuar disa apartamente në këtë objekt të ndërtuar. Ne vijim sqarojnë se me shtetasin Ermal Muçaj, kanë lidhur një kontratë prenotimi dhe dorëzimi për dy apartamente në datën 30.11.2010, me sip. 92 m² dhe 63.1 m². Sqarojnë se shtetasi Ermal Muçaj, ka paguar në llogarinë e P. Osmenej shumë 45.000 euro, ne datën 24.12.2010, nëpërmjet Raiffeisen Bank,*

nga vlera totale e përcaktuar në këtë kontratë. Palët deklarojnë se me shoqërinë ndërtuese kanë patur marrëdhënie edhe për pasuri të tjera në këtë objekt, si pronare trualli-shoqëri ndërtuese, për të cilat janë likuiduar në vijim. Në këto kushte, me dakortësinë e tyre si pronarë trualli dhe shoqërisë, në përfundim të objektit, rezultoi se këto pasuri i takonin shoqërisë “****”. Për këtë arsye këto dy apartamente janë hipotekuar në emër të kësaj shoqërie në vitin 2011. Sqarojnë se me shoqërinë ndërtuese janë likuiduar totalisht sa i përket kësaj pasurie dhe nuk kanë pretendime, pasi janë rregulluar me pasuri të tjera në këtë objekt.

- Deklaratë e thjeshtë nga shtetasi A.L, datë 03.11.2023, i cili deklaron se është përfaqësues ligjor, si dhe ortak i vetëm në shoqërinë *** shpk, me Nipt K61806001L. Deklaron se shoqëria *** shpk, ka ndërtuar një objekt, godine banimi dhe shërbime, sipas lejes së ndërtimit miratuar nga KRRT Bashkia Tiranë, nr. *** prot, datë 14.10.2005 dhe vendimit të lejes së ndërtimit nr. ***, datë 4.2.2006, me subjekt ndërtues shoqëria *** shpk, ndodhur në rrugën "Irfan Tomini", Tiranë, në truallin e vënë në dispozicion nga pronarët P. dhe K. Osmenej. Në vijim, referuar dokumentacionit përkatës, sqaron se Ermal Muçaj, kishte prenotuar nga shtetasi P. dhe K. Osmenej dy apartamente me sipërfaqe 92 m² dhe 63.1 m², në katin e pestë, të cilët i kishin përfituar këta apartamente si pronarë trualli, ku u ndërtua objekti nga shoqëria *** shpk. Duke qenë se shoqëria ka patur marrëdhënie me pronarët e truallit edhe për pasuri të tjera në vazhdim, në dakortësi me njeri-tjetrin (pronarët e truallit dhe Ermal Muçaj), vendosën që Ermali ti jepte shoqërisë ***, apartamentin me sipërfaqe 81 m², pasi kishte paguar edhe vlerën prej 45.000 euro, nëpërmjet kredisë bankare në Raiffeisen Bank, në vitin 2010, dhe të nënshkruhej kontrata e shitblerjes. Kjo zgjidhje u bë për shkak se Ermal Muçaj do të përfitonte një apartament me të madh në sipërfaqe, se ai që kishte deri në atë moment. Pra në përfundim të ndërtimit, këto dy apartamente i takonin shoqërisë ndërtuese. Kjo vërtetohet edhe nga fakti që ky apartament është regjistruar dhe hipotekuar në emër të shoqërisë ***, në vitin 2011, me një sipërfaqe të përgjithshme tashme prej 136 m². Në vijim, pasi palët ranë dakord për sa me sipër, u nënshkrua kontrata e shitblerjes në datën 30.09.2011, me shoqërinë *** shpk, për apartamentin me sip. 136 m², në vlerën totale prej 61.200 euro. Ky është i njëjti apartament me dy apartamentet e prenotuara, por kjo është sipërfaqja neto totale e tyre e bashkuar. Kjo vere u përcaktua duke llogaritur vlerën e paguar me kredi bankare pronarëve të truallit dhe diferencën me kthimin e apartamentit me sipërfaqe 81 m². Referuar sa me sipër, në vijim Ermal Muçaj dhe bashkëshortja e tij, i kanë dhënë shtetasi A.L, një prokurë në datë 30.09.2011, për apartamentin me sipërfaqe 81 m², i ndodhur në rrugën "I.T", Tiranë, me tagrin për ta shitur dhe me të drejtë për të përfituar vlerën nga kjo shitje në lidhje me këtë apartament. Ky veprim është bërë në të njëjtën datë me kontratën e shitblerjes së apartamentit, në datën 30.09.2011. Referuar dokumentacionit përkatës, rezulton se në datën 02.11.2012, është firmosur kontrata për shitjen e këtij apartamenti në vlerën 7.128.000 lekë, vlerë të cilën e ka përfituar A.L, sipas prokurës, ndërsa shtetasi Ermal Muçaj dhe bashkëshortja e tij, nuk kanë përfituar vlerë nga kjo shitje.

33. Në pyetësin nr 1 datë 27.02.2024 i pyetur nga Relatori i çështjes në lidhje me apartamentin nr.***, Rruga ***, me sipërfaqe 136 m², subjekti ka deklaruar:

- ... lidhur me kontratën e prenotimit të dy apartamenteve, me kontratë nr. *** rep, nr. 1074/2 kol, datë 30.11.2010, me sipërfaqe 92 m² dhe 63.1 m², prenotuar nga shtetasi P. dhe K. Osmenej, në vlerën 90.000 euro, ky është apartamenti të cilin e kam deklaruar, me sipërfaqe totale 136 m². Për këtë apartament kam marrë kredi bankare në Raiffeisen Bank, në muajin dhjetor 2010, në vlerën 45.000 euro, e cila është transferuar në llogari të P. Osmenej, i cili i kishte përfituar këto apartamente si pronar i truallit. Siç e kam sqaruar, pavarësisht se kontrata dhe pagesa u krye me palët e mësipërme, pasi u ndanë pjesët takuese mes pronarëve të truallit dhe shoqërisë

së ndërtimit, këto dy apartamente në përfundim rezultoi se i takonin shoqërisë ndërtuese, në marrëveshje me njëri tjetrin. Për këtë arsye edhe këto apartamente u hiptekuan në emër të shoqërisë “***” shpk, sipas v[er]tetimit hipotekor në datën 19.9.2011, me një sipërfaqe totale të vetme tashmë prej 136 m2. Për këtë arsye edhe kontrata përfundimtare e shitblerjes u lidh me këtë shoqëri. Dua të sqaroj se përveç vlerës prej 44.745 euro, të cilën ja kam paguar pronarëve të truallit si më sipër, kam rënë dakort dhe i kam dhënë edhe apartamentin e parë me sipërfaqje 81 m2, në pronësinë time, shoqërisë së ndërtimit “***” shpk, me pronar A.L. Kjo në dakortësi të plotë mes palëve, edhe me pronarin e truallit P. Osmenej. Pra (shuma 44.745 euro + apartamenti 81 m2), janë dhënë nga ana ime, dhe kam përfutur apartamentin me sipërfaqje 136 m2.

- Sa i përket pyetjes tuaj “...përse është bërë një pagesë më e ulët sesa specifikohet në kontratë, dhe a keni një dokument që justifikon deklarin...”, sqaroj se vlera e përcaktuar në kontratën e datës 30.11.2012 ka qënë 90.000 euro, dhe nga kjo vlerë nëpërmjet kredisë bankare të marrë në Raiffeisen Bank, i kam paguar pronarit të truallit me të cilin është lidhur edhe kontrata e prenotimit për dy apartamentet, vlerën 44.745 euro, dhe përveç kësaj vlere i kam dhenë pronarit të *** shpk, shtetasit A.L edhe apartamentin e parë me sipërfaqje 81 m2, porositur dhe paguar shoqërisë *** shpk, sipas marrëveshjes me pronarët e truallit dhe firmës ndërtuese. Kjo pasi në përfundim këto dy apartamente i takuan firmës ndërtuese Fa-Ma Konstruksion, siç e sqarova më lart. Pra në total për këto dy apartamente kam paguar 44.745 euro si dhe kam dhenë apartamentin e parë me sipërfaqje 81 m2 me prokurën përkatëse e cila është nënshkruar në të njëjtën datë me kontratën e shitblerjes konkretisht më datë 30.9.2011, pavarësisht vlerës së cituar në kontratë. Jo pa qëllim janë bërë në të njëjtën datë, gjë që tregon edhe lidhjen e asaj që unë sqarova, pra të dakortësisë mes meje dhe pronarit të firmës ndërtuese. Pra, nuk kemi të bëjmë me një vlerë më të ulët, por me një vlerë tashmë të negociuar mes palëve (meje, pronarit të truallit dhe firmës ndërtuese) duke qenë se përveç vlerës monetare të paguar, kam dhënë/këmbyer edhe apartamentin me sip. 81 m2. Në lidhje me dokumentacionin provues, sqaroj se kam paraqitur pranë ILDKPKI, deklaratë nga shtetasit P. dhe K. Osmenej, si dhe një deklaratë nga shtetasi A.L, pronari i firmës *** dhe *** shpk, të cilët konfirmojnë atë që ka ndodhur dhe që unë shpjegova më lart.
- Apartamentet e deklaruara kanë patur sipërfaqen 92 m2 dhe 63.1 m2, në kontratën e prenotimit dt. 30.11.2010, por kur janë hipotekuar në emër të shoqërisë ndërtuese *** shpk, janë bashkuar në një sipërfaqje të vetme, konkretisht në pasurinë me numër pasurie 6/440+1-19, zk. 8260, me sip. banimi 136 m2 + 12.5 m2 sip. e përbashkët, në katin e pestë, ndodhur në rrugën ***, Tiranë, siç përcaktohet edhe tek kontrata e shitblerjes dt. 30.09.2011.
- Në kontratën e prenotimit të datës 30.11.2010, dy apartamentet e cituara ndodhen konkretisht në katin e pestë, në rrugën ***. Pra qartazi kemi të bëjmë me të njëjtin kat, katin e pestë, ku ndodhen dy apartamentet e prenoturara, bashkuar në një sipërfaqje totale, si më sipër. Përveç kontratave, për të vërtetuar këtë fakt kam paraqitur edhe deklaratë nga shtetasi A.L, pronari i firmës *** shpk, por edhe nga shtetasit P. dhe K. Osmenej, të cilët theksojnë se këto dy apartamente janë hipotekuar në emër të kësaj shoqërie në vitin 2011, çka vërtetojnë këtë fakt, referuar dokumentacionit të pronësisë.

I pyetur ne lidhje me apartamentin me sip.86 m2 subjekti ka deklaruar :

34. *“Në lidhje me pyetjen tuaj, sqaroj se sa i përket apartamentit me sipërfaqe 86 m2, sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 23.05.2005, lidhur me shoqërinë e ndërtimit *** shpk, është paguar nga ana ime në total 35.000 euro shoqërisë së ndërtimit. Konkretisht janë paguar 10.000 euro me nënshkrimin e kontratës, ndërsa vlera 25.000 euro është bërë në momentin e marrjes së kredisë, në muajin maj 2006. Ky apartament siç kam sqaruar edhe në shpjegimet e mia pranë ILDKPKI, pavarësisht se është lidhur me firmën ndërtuese, i përkiste de facto shtetasit S.D, si pronar i truallit ku është ndërtuar objekti, me të cilin kam patur marrëdhënie shoqërore shumë të afërta dhe për të cilin kemi rënë dakort që të paguaja vetëm këtë vlerë nga ajo e parashikuar në kontratë (43.000 euro), pa patur më pretendime të tjera mes palëve. Shtetasi S.D kishte edhe pasuri të tjera në këtë objekt si pronar trualli, me të cilin janë bërë edhe likuidimet financiare, sipas marrëveshjeve që shoqëria kishte me këtë shtetas, si dhe për pasuri të tjera në vijim, ndërmjet tij si pronar trualli dhe shoqërisë ndërtuese. Pra likuidimet përkatëse monetare/pronësie, i kanë bërë me njëri tjetrin. Unë kam paguar sipas dakortësisë mes palëve vetëm vlerën 35.000 euro nga ajo e parashikuar në kontratë. Kjo edhe bazuar në sqarimet përkatëse të paraqitura nga ana ime si dhe nga deklaratat e shtetasve A.L pronari i shoqërisë *** shpk, gjithashtu edhe nga S.D, të cilët konfirmojnë deklaratimet e mia. Lidhur me sipërfaqjen dhe katin e apartamentit parashikuar në dy kontratat, përkatësisht; në kontratën e sipërmarrjes së datës 23.05.2005, ka për objekt ndërtimin e një apartamenti 2+1 me sipërfaqje 86 m2, së bashku me sipërfaqen e shkallëve, ndodhur në “katin e pestë popullor”, ndërsa në kontratën e shitblerjes së datës 20.8.2007, ka për objekt shitblerjen e një apartamenti me numër pasurie ***, me sipërfaqe banimi 81 m2, “kati 4”, e ndodhur në Tiranë. Pra në kontratën e sipërmarrjes e cila nuk është përpiluar para një noteri por është bërë mes palëve, është shprehur kati i pestë popullor që përfshin edhe katin e dyqaneve, ndërsa në kontratën e shitblerjes e noterizuar është përcaktuar kati i katërt (teknik), i cili llogaritet mbi dyqanet. Ndërsa për sa i përket sipërfaqjes së banimit, tek kontrata e sipërmarrjes është sipërfaqja 86 m2 bashkë me sipërfaqjen e shkallëve, ndërsa në kontratën e shitblerjes është përcaktuar sipërfaqja 81 m2, sipërfaqje banimi, pra pa përfshirë sipërfaqjen e përbashkët. Në këtë sipërfaqje ka dalë edhe vërtetimi nga dokumenti hipotekor, i datës 18.07.2007 dhe 7.11.2011. Pra kemi të bëjmë me të njëjtin apartament të përcaktuar në dy kontratat respektive. Për të vërtetuar këto që unë thashë kam paraqitur edhe deklaratë nga shtetasit A.L, dhe S.D. Lidhur me vlerën e përcaktuar në kontratën e shitblerjes, përcaktuar në vlerën 2.000.000 lekë, sqaroj se kjo vlerë është vendosur nga ana e noterit vetëm si vlerë referenciale, në kontratë, pasi pagesat për këtë apartament janë kryer nga ana ime më parë, konkretisht në vitin 2005 dhe 2006, në total 35.000 euro, (sqaruar më lart), vlera këto të dokumentuara”. ...*
35. Bazuar në deklarinimin e subjektit, sqarimet dhe dokumentacionin e paraqitur dokumentacionin e administruar, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezulton se: Apartamenti me sip. 136 m2 në Rr. “****”, Tiranë, me vlerë sipas kontratës së shitblerjes 61.200 euro është blerë nga subjekti në vitin 2011 shoqërisë “*****” shpk, me burim nga kredi bankare në Raiffaisen Bank, në shumën 45.000 euro, si dhe dhënien e apartamentit me sip.81 m2 kësaj shoqërie, blerë nga subjekti në vitin 2007. Fillimisht janë prenotuar dy apartamente me sipërfaqe respektive 92 m² dhe 63.1 m² duke kaluar në llogarinë e pronarëve të truallit P. dhe K. Osmenej, vlerën e marrë kredi. Kontrata e shitjes u finalizua më 30.09.2011 me shoqërinë “*****” shpk, në vlerën 61.000 euro, kjo pasi në të njëjtën datë është përpiluar prokura nëpërmjet së cilës subjekti i jep të drejtën shtetasit A.L, pronarit të shoqërisë, që të shesë dhe të përfitojë të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip.81 m2, në pronësi të Ermal Mucaj, i ndërtuar nga shoqëria “*****” shpk.

36. Apartamenti me sip. 81 m2 (bruto 86 m2) është prenotuar në vitin 2005 pranë shoqërisë "****" shpk, ku janë shlyer 35.000 euro, nga të cilat 10.000 Euro me lidhjen e kontratës, me burim të ardhura familjare dhe 25.000 Euro me kredi bankare ne ABI Bank, në vitin 2006. Kontrata përfundimtare e blerjes për këtë apartament është lidhur me pronarin e truallit, S.D, në vitin 2007, pasi ky apartament i përkiste de facto këtij shtetasi. Shoqëria "****" shpk dhe shoqëria "****" shpk, kanë ortak te vetëm shtetasin A.L. Konstatohet se apartamentin e blerë në vitin 2007, me sip. 81 m2, subjekti në vitin 2011 e ka vënë në dispozicion te ortakut te shoqërisë se ndërtimit, nga e cila blen apartamentin me sip. 136 m2, të cilin ka në pronësi. Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues, lidhur me apartamentin e deklaruar me sip. 136 m2 në Rr. "****", Tiranë, si dhe për apartamentin me sip. 81 m2 ne Rr. "****", të cilin e ka pasur në pronësi. Subjekti ka deklaruar shpenzime mobilimi dhe punime të brendshme ne shumën rreth 25.000 euro, gjatë periudhës deri në vitin 2012.

- ASHK nuk konfirmon pasurinë e regjistruar ne emër te subjektit.
- Konfirmohen kreditë e marra nga ABI Bank dhe RFZ Bank.

37. **Pasuri nr.2. Depozita bankare** në Abi Bank, në shumën 80.035 euro (transferuar nga nr. im i llogarisë në RFZ Bank, në datë 17.06.2020), me burim të ardhura të përfituara nga kompania e sigurimeve ALLIANZ spa, si dëmshpërblim për aksidentin me pasojë të familjes ne Itali, në shumën 100.000 euro, si dhe shuma 20.000 euro transfertë nga motra në Itali, në llogarinë time bankare ne RFZ Bank, duke qenë se ajo ishte përfituese e shumës në total 184.000 euro, si dëmshpërblim për aksidentin me pasojë të familjes, në Itali. Vlera 80.035 euro. Zotëron 100 %.

38. **Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka paraqitur:**

- Nxjerrje llogarie nga ABI Bank, datë 27.1.2023, për llogari kursimi në euro, në emër të Ermal Muçaj, me balancë në vlerën 80.035 euro.
- Prokurë e posaçme, nr. *** rep, nr. *** kol, datë 12.08.2018, me porositës Ermal Muçaj, djali legjitim i Petrit Muçaj, si dhe trashëgimtar i tij, në lidhje me aksidentin që ka ndodhur më 05.08.2017, në Barletta - Maglie, në automjetin me targa CE ***, në pronësi dhe i drejtuar në këtë rast nga Marieta Muçaj (nëna e të nënshkruarit), të shoqërisë së sigurimit Allianz Ass.ni spa, në të cilin udhëtonte Petrit Muçaj, i cili ka humbur jetën me datë 02.06.2018, si pasojë e këtij aksidenti, për shkak të dëmtimeve të rënda. Me anë të kësaj prokure autorizon avokatin Nicola Spiniello të kryejë konsulencën, si dhe te gjitha veprimet e nevojshme, ne lidhje me praktikën e kompensimit për dëmet e pësura nga Petrit Muçaj, nga aksidenti i lartpërmendur. Tarifa për veprimtarinë e kryer nga avokati është e përcaktuar nga kompania e sigurimeve, ashtu si dhe detyrimet e tjera ligjore. Porositësi pranon të autorizojë likuidimin e dëmeve nëpërmjet transferimit bankar.
- Vërtetim nënshkrimi në gjuhën shqipe dhe italiane nga noteri.
- Nxjerrje llogarie nga banka Credito Cooperativo di Spinazzola (në gjuhën italiane), datë 29.03.2019, për llogari në euro, ku konfirmohet një kreditim në datën 21.02.2019, në vlerën 122.800 euro, si dhe në transfertë në datën 13.03.2019, në vlerën 20.015 euro, me përshkrimin "Bonifico all'estero, Ben: Ermal Petrit M. Risarcimentoassicurat"
- Shkresë (në gjuhën italiane) nga Av. Nicola Spinella, ku jepen të dhënat bankare të përfituesve Ermal Muçaj, në vlerën 100.000 euro në Raiffeisen Bank, Tiranë dhe Ilda Muçaj, në vlerën 184.000 euro, në Banca Popolare di Bari.
- Shkresë (në gjuhën italiane), datë 05.08.2017, akt transaksioni, ku i nënshkruari Ermal Muçaj, deklaroi të marrë shumën prej 100.000 euro, nga "Allianz spa", për dëmet e aksidentit të ndodhur ndaj shtetasit Petrit Muçaj.

- Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 08.05.2023, ka bashkëlidhur CD të llogarive bankare të Ermal Muçaj, ku konfirmohet kreditimi në datë 07.02.2019, i vlerës 100.000 euro, nga "Allianz spa", me përshkrimin "Bonifico da Allianz spa, Muçaj Petrit", si dhe një kreditim në datën 15.03.2019, në vlerën 19.949 euro, nga "Muçaj", me përshkrimin "Regalo derivante da risarcimento assicurativo". Në datën 17.06.2020 tërheq nga llogaria 81.000 euro me përshkrimin "Tërheq, kalim në bankë tjetër". Në datën 18.03.2019 transferon pagesën e fundit të kështit të kredisë në vlerën 36.303 euro.
- ABI Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 08.5.2023, konfirmon në emër të Ermal Muçaj, llogari kursimi në euro, me gjendje në datë 03.03.2023, në vlerën 80.035 euro.
- ✓ **Konfirmohet kreditimi i vlerës 80.000 euro, në datën 17.06.2020, me përshkrimin "Cash deposit in foreign currency, Ermal Muçaj derdhje në llogarinë e kursimit".**

39. Trupa e Vlerësimit ka administruar :

- Nxjerrje llogarie nga Banca Popolare di Bari, (në gjuhën Italiane), për llogari në euro në emër të Ilda Muçaj, ku konfirmohet se në datën 05.02.2019, kreditohet vlera 184.000 euro, me përshkrimin "*Bonifico a vostro favore, Allianz s.p.a*" dhe në datën 21.02.2019, transferohet vlera 122.800 euro, me përshkrimin "*Emmissione assegno circolari*" .
- Nxjerrje llogarie bankare në gjuhën italiane, për llogari në euro në emër të Ilda Muçaj, ku konfirmohet se në datën 13.03.2019 transferohet vlera 20.015 euro, me përshkrimin "*Ben.Ermal Muçaj, al regalo derivante da risarcimento assicurato*".

40. Konstatohet se llogaria e kursimit në Abi Bank, në vlerën 80.035 euro, është çelur në vitin 2020, me burim transfertat nga llogaria e subjektit në RFZ Bank, ku janë kredituar shumat 100.000 euro në dt.07.02.2019, nga kompania e sigurimit "Allianz"spa, si dhe 19.949 euro, në dt.15.03.2019, dhurim nga motra e tij Ilda Muçaj, të cilës i ka kaluar nga shoqëria "Allianz"spa, në dt.05.02.2019, shuma 184.000 euro, në Banca Popolare di Bari. Burimi i kreditimeve janë dëmshpërblim për aksidentin me pasojë vdekjen të babait të subjektit.

41. Pasuria nr.3. Llogari rrjedhëse në euro, në bankën Raiffeisen, me gjendje në shumën 454 euro, me burim të ardhurat e përfituara nga kompania e sigurimeve "Allianz" spa, si dëmshpërblim për aksidentin me pasojë të familjes, në Itali. Zotëron 100 %.

Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka dorëzuar:

- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, datë 27.01.2023, për llogari në euro, në emër të Ermal Muçaj, për periudhën 17.01.2022-15.12.2022

➤ Raiffeisen Bank konfirmon llogarinë në euro në shumën 336 euro.

42. Pasuri nr. 4. Llogari page në Raiffeisen Bank me gjendje në shumën 58.890 lekë. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, për llogari në lekë, në emër të Erik Muçaj, për periudhën 2008-2021.
- 43. Raiffeisen Bank** konfirmon në emër të Erik Muçaj, llogari në lekë, me gjendje në datë 03.03.2023, në vlerën 68.559 lekë.

✓ **Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e Raiffeisen Bank.**

44. Pasuri nr. 5. Llogari kursimi në RFZ Bank për fëmijë, në emër të Ergi Muçaj, me gjendje në shumën 68.559 lekë. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, për llogari në lekë, në emër të Ergi Muçaj, për periudhën 2008-2021.

✓ **Raiffeisen Bank konfirmon deklarinin e subjektit.**

II.Deklarimi i të ardhurave.

- Të ardhura nga paga, shpërblime si oficer në Ministrinë e Brendshme, për periudhën Tetor 1997- Dhjetor 2023 në total 22 699 490 lekë.
- Të ardhura nga shitja e automjetit tip Audi A3, me targa AA*** JG, në shumën 4.500 euro, sipas kontratës së shitjes me nr.***, datë 11.08.2015.
- Të ardhura nga shitja e automjetit tip Volkswagen Touareg, me targa DA *** SA, në shumën 6.000 euro+ automjetit tip BMW, sipas kontratës së shitjes nr.*** datë 13.08.2013. automjeti rezulton në pronësi të F.P dhe subjekti është përfaqësues me prokurë nr.***, datë 07.04.2013.
- Të ardhura nga shitja e automjetit tip BMW *** XD , sipas kontratës së shitjes nr.***, datë 14.09.2014 me vlerë 6.000 euro.

Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka dorëzuar :

- Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme nga ISSH, që vërteton pagat bruto të Ermal Muçaj për periudhën 01.10.1997 – 01.04.1999, në vlerën totale 233.348 lekë.
- Vërtetim nga Akademia e Sigurisë, nr. E-28 prot., datë 28.02.2023, ku vërteton se Ermal Muçaj, ka qenë punonjës policie në Akademinë e Sigurisë, nga data 01.05.2017 deri më 31.09.2020, dhe ka përfituar të ardhura neto nga paga dhe shpërblime në vlerën totale rreth 3.392.000 lekë.
- Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme nga ISSH, nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, datë 03.03.2023, që vërteton se pagat neto të Ermal Muçaj, për periudhën Prill 2013-Shtator 2014, në vlerën totale rreth 1.422.000 lekë dhe Tetor 2021- Dhjetor 2022, në vlerën totale 1.574.000 lekë
- Vërtetim nga DVP Lezhë, që vërteton se Ermal Muçaj për periudhën Tetor 2016-Prill 2017, ka përfituar të ardhura neto nga paga në vlerën 572.446 lekë.
- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, për llogari në lekë, në emër të Ermal Muçaj, për periudhën 2005-2022.
- Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, ka bashkëlidhur CD të llogarive bankare të subjektit, ku konfirmon kreditimet nga paga, shpërblime, honorarë, veshje dhe dieta për periudhën 05.05.2005-03.03.2023, në vlerën totale rreth 18.770.000 lekë.
- ISSH, me shkresën nr. *** prot., datë 15.05.2023, konfirmon pagat bruto/neto të subjektit për periudhën, Dhjetor 2012- Prill 2023, nga Drejtoria e Forcës së Posaçme, Drejtoria e Policisë Qarku Vlorë, Drejtoria e Policisë Qarku Lezhë, Akademia e Sigurisë, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Policisë Qarku Korçë, dhe Drejtoria e Policisë Qarku Vlorë.
- DPSHTRR, me e-mailin e datës 07.06.2023, ka bashkëlidhur dokumentacionin si më poshtë:
- Kontrate shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.07.2012, me pala shitëse A.B dhe blerës Ermal Muçaj, për automjetin me targë AK *** SD, tip Audi A3, viti 1997, në vlerën 20.000 lekë.

- Kontrate shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 30.08.2012, me palë shitëse Ermal Muçaj dhe blerës A.K, për automjetin me targë AA *** EP, tip Audi 43, viti 1997, në vlerën 100.000 lekë.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol, date 31.8.2012, me palë shitëse E.R dhe blerës Ermal Muçaj, për automjetin me targë AA *** BR, tip BMW 330 XD, viti 2005, në vlerën 1.000.000 lekë.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 14.9.2014, me palë shitëse Ermal Muçaj dhe blerës A.N, për automjetin tip BMW *** XD, në vlerën 6.000 euro.

44. Trupa e vlerësimit ka administruar:

- Kontratë shitblerje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 05.09.2014, me palë shitëse D.G dhe blerës Ermal Muçaj, për automjetin me targë AA***JG, tip Audi A3, në vlerën 6.000 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitblerje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.08.2015, me palë shitëse Ermal Muçaj dhe blerës A.P, për automjetin me targë AA***JG, tip Audi 3, në vlerën 4.500 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Prokurë e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 07.04.2013, me palë F. P, i cili i jep tagër dhe kompetence të plote shtetasit Ermal Muçaj, të nënshkruaje kontratën e shitjes së kalimit të pronësisë së mjetit tip VV Touareg, automjet në pronësi të F.P, sipas dokumentacionit. I jep të drejtë të shesë, të gjejë blerësin, t'ia shesë vetes së tij, dhe të paguajë të gjitha detyrimet tatimore. Veprimet e përfaqësuesit i konsideron të mirëqena njëlloj sikur të ishin kryer nga ai personalisht. Bashkëlidhur praktika.
- Kontratë shitje nr. *** rep., nr. ***kol., datë 13.08.2013, me pale shitëse Ermal Muçaj dhe blerës, Tirana *** shpk. Shitësi në bazë të prokurës nr. *** rep., nr. *** kol., , ka në pronësi një automjet tip Touareg, të cilin j'a shet blerësit kundrejt këmbimit të një automjeti tip BMW, si dhe shumën e përcaktuar në vlerën 6.000 euro, vlerë e cila është likuiduar nga ana e blerësit në favor të shitësit.
- Kontratë shitje nr. *** rep, nr. *** kol., datë 13.08.2013, me palë shitëse “Tirana ***” sh.p.k dhe blerës Ermal Muçaj. Shitësi ka në pronësi një automjet tip BMW, me targë DP ***DE, viti 2008. Këtë mjet, shitësi ia shet blerësit kundrejt shumës prej 20.000 euro, ku sot blerësi ka këmbyer një automjet tip VV Touareg, në vlerën 14.000 euro, si dhe ka paguar vlerën 6.000 euro në favor të shitësit. Bashkëlidhur praktika.

45. Në proces verbalin e datës 18.10.2023. subjekti ka sqaruar se në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga ana e tij, për periudhën 2005 - 2023, ka deklaruar vetëm të ardhurat nga paga dhe shpërblimet. Lidhur me të ardhura për periudhën Prill 1997- Prill 2005, në vlerën e deklaruar prej 4.500.000 lekë, subjekti ka paraqitur dokumentacion përkatës për të justifikuar këtë shumë, të përlllogaritur paraprakisht prej tij me përafërsi, duke llogaritur të ardhurat bruto për këtë periudhë gjatë plotësimit të deklaratës.

46. Në lidhje me të ardhurat e deklaruara, nga automjeti tip Touareg, sqaron se ky automjet i është dhënë në përdorim nga shtetasi Fatmir Picari, me prokurën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 07.04.2013, ku kishte të drejtë përdorimi, por edhe të nënshkruante kontratën e shitjes për këtë automjet. Me shtetasin F.Picari ka patur marrëdhënie shoqërore shume kohë me parë. Sqaron se këtë automjet e ka përdorur nga data e nënshkrimit të prokurës deri në datën 13.08.2013, ku ka përpiluar kontratën me shoqërinë “Tirana ***” shpk, duke këmbyer automjetin tip Touareg (i cili u vlerësua në shumën 14.000 euro), me një automjet tip BMW 330 (i cili u vlerësua në shumën 20.000 euro), si dhe ka shtuar diferencën në vlerën 6.000 euro. Pasi ka marrë automjetin tip BMW e ka përdorur deri në datën 07.11.2013, ku ka përpiluar kontratën e shitblerjes, duke e shitur këtë automjet në vlerën 950.000 lekë. Sqaron se të gjitha veprimet i ka kryer për llogari të

personit i cili i ka lëshuar prokurën, si dhe shuma pas shitjes së automjetit tip BMV, në datë 07.11.2013, i është kthyer sërish atij, pasi subjekti ishte vetëm përfaqësues me prokurë, për të nënshkruar kontratat përkatëse dhe për të gjetur blerësin. Ka paraqitur kontratën e shitjes së këtij automjeti.

48. Me inventarin e datës 06.11.2023, subjekti ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, me punëdhënësin Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër, që vërteton se Ermal Muçaj, për periudhën 01.10.1997 - 01.04.1999, ka realizuar të ardhura bruto, në vlerën totale rreth 233.000 lekë.
- Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, që konfirmon se Ermal Muçaj, për periudhën 01.04.1999 - 31.12.2003, ka realizuar të ardhura neto nga paga dhe shpërblime, në vlerën totale 1.905.000 lekë.
- Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, që konfirmon se Ermal Muçaj, për periudhën 01.01.2004 - 30.04.2005, ka realizuar të ardhura neto nga paga dhe shpërblime, në vlerën totale rreth 903.000 lekë.
- Kontratë shitblerje nr. ***rep, nr. *** kol, datë 07.11.2013, me palë shitëse Ermal Muçaj dhe blerës Altin Ymeri, për automjet tip BMV, viti 2008, në vlerën 950.000 lekë, vlerë e likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- ✓ Te ardhurat neto te subjektit nga paga, shpërblime, dieta etj., për periudhën Tetor 1997 - Mars 2023, janë në vlerën totale rreth 21.811.000 lekë.
- ✓ Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion lidhur me automjetet e shitura, të deklaruara dhe të konfirmuara nga DPSHTRR.

49. I pyetur nga Trupa e Vlerësimit në lidhje me automjetet në pronësi subjekti ka vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin e duhur ligjor si dhe ka dhënë sqarimet si më poshtë:

- Automjeti tip Audi Audi A3, me targë AA***EP, në pronësinë time, të cilin e kam blerë në datën 31.07.2012, në vlerën 20.000 lekë, dhe e kam shitur në datën 30.08.2012 në vlerën 100.000 lekë. Numri i shasisë (E*****3185).
- Automjeti tip BMV 330XD, me targë AA***BR, në pronësinë time, të cilin e kam blerë në datën 31.08.2012, në vlerën 1.000.000 lekë, dhe e kam shitur në datën 14.09.2014, në vlerën 6.000 euro. Numri i shasisë (EB*****).
- Automjeti tip Audi A3, me targë AA***JG, në pronësinë time, të cilin e kam blerë në datën 05.09.2014, në vlerën 6.000 euro, dhe e kam shitur në datën 11.08.2015, në vlerën 4.500 euro. Numri i shasisë (E*****70307).
- Automjeti tip Vë Touareg (me numër shasisë E*****99), automjet i cili më është dhënë në përdorim nga shtetasi F. Picari, me prokurën nr. *** rep, nr. *** kol, datë 07.04.2013, ku kam patur të drejtë të nënshkruajë kontratën e shitjes për këtë automjet, për llogari të të përfaqësuarit. Këtë automjet e kam këmbyer në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë, me automjetin tip BMë 330D.
- Automjet tip BMë 330D, (me numër shasisë EB*****7350) me targë DP**DE, të cilin e kam këmbyer me automjetin tip Vë Touareg me shoqërinë Tirana's Supercar shpk, në datën 13.8.2013, në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë, nr. 587 rep, nr. 394 kol, datë 7.4.2013, të shtetasit Fatmir Picari. Këtë automjet (BMë 330D), e kam shitur në datën 7.11.2013, në vlerën 950.000 lekë. Të gjitha veprimet, si këmbimin, shitjen, i kam kryer për llogari të personit i cili i ka lëshuar prokurën, konkretisht të shtetasit F. P

- Automjet tip Audi me targa AA686DD, (me numër shasie ĒAUZZZ8P46A120421), ku unë kam qënë përfaqësues me prokurë nr. 1452 rep, nr. 354/1 kol, datë 14.4.2014, i shtetases Lindita Goxhaj, ku kam kryer shitjen e këtij automjeti për llogari të kësaj shtetase në datën 14.6.2014, në vlerën 5.000 euro, me kontratën përkatëse.

Dua të sqaroj gjithashtu se në deklaratën e pasurisë së vlerësimit kalimtar, automjetet si më poshtë, meqenëse nuk i disponoj, i kam deklaruar tek rubrika e të ardhurave;

- a) Të ardhura nga shitja e automjetit tip Audi A3, me targa AA***JG, në vlerën 4.500 euro, sipas k.shitjes nr. ***, datë 11.8.2015.
- b) Të ardhura nga shitja e automjetit tip Vë Touareg, me targa DA***SA, në vlerën 6.000 euro + automjet tip BMË 330D, sipas k.shitjes nr. *** datë 13.8.2013. Automjeti rezulton në pronësi të F.P dhe unë jam përfaqësues me prokurë nr. 587/394, datë 7.4.2013.
- c) Të ardhura nga shitja e automjetit tip BMË 330 XD, në shumën 6.000 euro, sipas k. shitjes nr. ***, datë 14.09.2014.

.....Në lidhje me detyrimet tatimore sqaroj se çmimet e blerjes, (pika nr. 2 dhe nr.3), janë më të larta se çmimet e shitjes, ndërsa për automjetin e përcaktuar në pikën nr. 1, diferenca e tyre ka qënë relativisht e vogël, përveçse unë duhet/mund të kem kryer edhe ndonjë shërbim lidhur me këtë automjet para shitjes. Përsa i përket automjeteve të tjera (pika nr. 4, 5 dhe 6), nuk kam patur detyrime tatimore pasi kam qënë thjesht përfaqësues me prokurë, pasi të ardhurat janë përfituar nga pronarët faktik të mjeteve, personat që kanë lëshuar prokurat përkatëse. Unë kam nënshkruar vetëm kontratat përkatëse, si më sipër...”

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe te gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit ne emër te subjektit ose personave të lidhur - Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.

- Shpenzime për UKT, konsumator familjar me kontrate nr. ***-1, gjatë periudhës Janar 2022- Janar 2023 janë rreth 34.863 lekë.
- Shpenzimet për energji elektrike, konsumator familjar me kontrate nr.TR*****176, gjate periudhës Janar 2022 - Janar 2023 janë rreth 124.231 lekë.
- Shpenzimet për telefon fiks dhe internet, gjate periudhës Janar 2022 - Janar 2023, Albtelekom, janë rreth 15.600 lekë.
- Shpenzimet totale për telefon celular Vodafone, gjatë periudhës janar 2022 - janar 2023, janë rreth 45.600 lekë.
- Shpenzime për internet Digicom, gjatë periudhës Janar 2022 - Janar 2023, janë rreth 23.000 lekë.
- FSHU, me shkresën nr. *** prot, datë 11.5.2023, konfirmon se me gjeneralitetet Ermal Muçaj rezulton një kontratë furnizimi, ne instancën Tiranë, adresa "I. Tomini, M. Kesh", kategoria familjare. Për periudhën Dhjetor 2021 - Nëntor 2022, shuma e paguar për energji elektrike është në vlerën totale 1 15.447 lekë.
- UK Fier, me shkresën nr. *** prot, datë 05.05.2023, konfirmon se Ermal Muçaj, ka kontratë në zonën Mallakastër (nuk disponohet kartë ID në sistem). Për periudhën Janar 2022 - Dhjetor 2022, shuma e paguar është ne vlerën totale 2.820 lekë.
- UK Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 25.05.2023, konfirmon se Ermal Muçaj, ka kontratë në zonën "I.T", me status aktiv. Për periudhën Janar 2022 - Dhjetor 2022, shuma e paguar është

në vlerën totale 34.882 lekë. Bashkëlidhur kontrata e shitblerjes se pasurisë së paluajtshme, nr. *** kol., datë 30.09.2011.

- “Digicom”, me shkresën nr. *** prot, datë 12.05.2023, konfirmon se Ermal Muçaj, ka marrë shërbim interneti faturuar në vlerën 2.990 në muaj, për periudhën janar dhjetor 2022. (Përllogaritur në vlerën totale vjetore 35.880 lekë).
- “Vodafone Albania” sha, me shkresën nr. *** prot., datë 14.07.2023, ka b/lidhur CD, ku konfirmon se në emër të Benarda Muçaj, korrespondon numri i celularit +355 69 39 66 761, joaktive. Gjithashtu informon se subjekti ose personat e lidhur mund të përdorin numër Vodafone, i cili është i regjistruar në emër të një subjekti (firmë, shoqëri etj.).
- “One Albania” sha, me shkresën nr *** prot., datë 07.06.2023, konfirmon në emër të Ermal Muçaj, numrin fiks 355 *****8. Totali i faturave nga data 1.01.2022 - 31.12.2022 është 13.200 lekë.
- 13 Shoqëritë Rajonale të UK, konfirmojnë se subjekti apo personat e lidhur, nuk figurojnë të kenë lidhur kontrata për shërbim furnizimi me ujë të pijshëm, pranë këtyre shoqërive rajonale.
- “Tring”, me shkresën nr. *** , datë 15.05.2023, nuk konfirmon kontratë të lidhur me subjektin apo personat e lidhur, për periudhën e kërkuar.
- Abissnet, me shkresën ***-Prot, datë 11.5.2023, nuk konfirmon kontratë të lidhur me subjektin apo personat e lidhur, për periudhën e kërkuar.

✚ *Ne proces verbalin e datës 18.10.2023, subjekti ka sqaruar se në lidhje me shpenzimet e deklaruara për celular në kompaninë Vodafone, se është numri i punës, i cili është në emër të Drejtorisë së Policisë. Në lidhje me përgjigjen e UK Fier, sqaron se nuk i përket atij, por duhet të jetë ndonjë shtetas tjetër me të njëjtin emër, pasi nuk disponon pasuri të paluajtshme përveç apartamentit në Tiranë.*

- Shpenzimet e deklaruara për ujë + drita + telefoni + internet gjatë periudhës së sipërcituar, me kontrata në emër të subjektit, rezultojnë në total rreth 243.000 lekë.
- ✓ Subjekti sqaroi në lidhje me përgjigjen e UK Fier.
- Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar, gjatë 3 viteve të fundit (kalendrike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara - Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022.
- Shpenzime për udhëtimet privatisht jashtë shtetit gjatë periudhës Mars 2020 – Shkurt 2023:
 - Dt. 18.9.2020 - 19.9.2020, kam qene ne Mal te Zi, shpenzuar rreth 100 euro.
 - Dt. 28.7.2021 - 31.7.2021, kam qene ne Greqi, shpenzuar rreth 250 euro
 - Dt. 19.3.2022 - 22.3.2022, b/shortja ka qene ne Stamboll, shpenzuar rreth 300 euro.
 - Dt. 9.12.2022 - 9.12.2022, djali Klei Muçaj ka qene ne Maqedoni, shpenzuar rreth 50 euro.

50. *Në proces verbalin e datës 18.10.2023, subjekti ka sqaruar se për shpenzimet e mësipërme të deklaruara nga ana e tij, nuk ka ruajtur fatura përkatëse. Subjekti ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:*

- Printimi nga Sistemi Tims, për të dhënat mbi hyrjet dhe daljet nga territori Shqiptar, të shtetasit Ermal Muçaj. Për periudhën 2020 - 2022, të dhënat janë si më poshtë: Dalje në dt. 18.09.2020 (Pika kufitare Murriqan), hyrje në dt. 19.09.2020 (Pika kufitare Murriqan). Dalje në dt. 28.7.2021 (Aegean-Athina, Komisariati i Policisë Rinas), hyrje në dt.31.07.2021 (Pika kufitare Kapshticë).

- Printimi nga Sistemi Tims, për të dhënat mbi hyrjet dhe daljet nga territori Shqiptar, te shtetas Benarda Muçaj. Për periudhën 2020 - 2022, te dhënat janë si më poshtë: Dalje ne dt. 19.3.2022 (Pegasus - Stamboll, Komisariati i Policisë Rinas), hyrje ne dt. 22.3.2022 (Pegasus - Stamboll, Komisariati i Policisë Rinas).
- Printimi nga Sistemi Tims, për të dhënat mbi hyrjet dhe daljet nga territori Shqiptar, te shtetasit Klei Muçaj. Për periudhën 2020 - 2022, të dhënat janë si më poshtë: Hyrje ne dt. 9.12.2022 (Autobus, Pika kufitare Qafa e Thanës).
- Printimi nga Sistemi Tims, për të dhënat mbi hyrjet dhe daljet nga territori Shqiptar, të shtetasve Erik dhe Ergi Muçaj, ku për periudhën 2020 - 2022, nuk konstatohen hyrje - dalje nga territori Shqiptar.
- ✓ ***Shpenzimet e deklaruar për udhëtimet private, personale dhe të personave të lidhur gjatë periudhës 2020 – 2022, rezultojnë në total rreth 700 euro.***

- ***Për arsimin e fëmijëve, madhore apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas periudhës se përcaktuar në nenin 32, të Ligjit të vlerësimit. Periudha nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrës Policore deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, subjekti ka deklaruar:***

- Shpenzime për arsimim dhe kualifikime. Pagesë për Universitetin Uisdom Bachelor në Drejtësi nga viti 2012 deri 2013, vlera 110.000 lekë. Pagesa fillestare për master në penale në Universitetin Shtetëror në Vlorë, ne tetor 2017, vlera 123.000 lekë.
- Shpenzime për arsimin e djalit Klei Muçaj pranë Tirana University Biznes, gjatë periudhës 2020 - aktualisht: Viti 2020 në shumën 218.000 lekë, viti 2021 në shumën 207.000 lekë, viti 2022 në shumën 116.000 lekë. Burimi i të ardhurave, dhuratë nga gjyshërit (prindërit e bashkëshortes). Pagesat janë bere me banke nga gjyshi M.Q. Vlera totale 541.000 lekë.

51. Në proces-verbalin e datës 18.10.2023. Subjekti sqaron se prindërit e bashkëshortes, lidhur me shpenzimet për shkollimin e djalit në UBT, kanë kontribuar rreth 200.000 lekë në total, dhe pjesa tjetër është mbuluar nga të ardhurat e tyre familjare.

52. Me inventarin e datës 06.11.2023, subjekti ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Diplomë Universitare "Bachelor" në Drejtësi, nga Uisdom University, datë 25.09.2013, në emër të Ermal Muçaj.
- Diplomë nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Fakulteti i Shkencave Humane, të Ermal Muçaj, data e regjistrimit 26.10.2017, data e përfundimit të studimeve 28.09.2022.
- Tabelë pagesash nga Tirana Business University, për shtetasin Klei Muçaj, ku konfirmohen pagesat për periudhën 11.11.2020 deri me datë 16.5.2023. Për periudhën 26.11.2020 deri më datë 14.02.2023, konfirmohen pagesa shkollimi në vlerën totale 565.640 lekë, (nga të cilat Myslim Qerimani paguan për shkollimin në total 207.000 lekë).

- Vërtetim nga ISSH, datë 27.05.2023, që vërteton se Myslim Qerimani, trajtohet me pension pleqërie, në masën mujore 44.939 lekë, dhe pension suplementar në masën 20.458 lekë. Për periudhën 2020 - 2022, të ardhurat janë në vlerën totale rreth 2.155.000 lekë.
- Vërtetim nga ISSH, datë 27.5.2023, që vërteton se Lumturi Qerimani, trajtohet me pension pleqërie, në masën mujore 28.402 lekë. Për periudhën 2020 - 2022, të ardhurat janë në vlerën totale rreth 936.000 lekë.
- ✓ **Shpenzimet e deklaruarra për arsimimin e subjektit dhe djalit Klei Muçaj, qjatë periudhës deri ne ditën e plotësimit te formularit te deklarimit te pasurisë, rezultojnë në total rreth 799.000 lekë, nga të cilat rreth 207.000 lekë, sipas dokumentacionit te paraqitur, janë paqar nga vjehrrri i subjektit, shtetasit M.Q.**

DETYRIME FINANCIARE

Subjekti ka deklaruar: Marrë hua me këste dorazi, deri në fillim të vitit 2012, nga kunati A. Qemirani (vëllai i bashkëshortes), shuma totale prej 85.000 USD, pa afat dhe pa interes. Huaja është përdorur për shlyerjen e kredisë për blerjen e apartamentit të parë, shpenzime të ndryshme familjare, blerje pajisje dhe arredim apartamenti etj. Detyrimi 85.000 USD.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Deklaratë e thjeshtë dore, në gjuhën Angleze, date 23.2.2018, (e përkthyer zyrtarisht në gjuhën shqipe nga përkthyes i licensuar, e vërtetuar nga noteri) nga shtetasi A.Q, me banim në qytetin e Nju Jorkut, i cili deklaroi se i ka dhënë hua në fillim të vitit 2012, kunatit të tij Ermal Muçaj, shumën prej 85.000 USD, për arsye familjare dhe për një periudhë prej 15 vitesh. Deklaroi se është i punësuar si teknik ashensorësh dhe realizon mbi 100.000 Usd në vit. Këto para ja ka dhënë hua nga kursimet e tij.
- Kartë identiteti nga Neë York State, A.Q .
- Dokumentacion në gjuhën angleze (U.S Individual Income Tax Return), për të ardhurat e përfituara nga A.Q, viti tatimor 2005, në vlerën totale 96.497 Usd.
- Dokumentacion në gjuhën angleze (U.S Individual Income Tax Return), për të ardhurat e përfituara nga A.Q, viti tatimor 2006, në vlerën totale 85.734 Usd.
- Dokumentacion në gjuhën angleze (U.S Individual Income Tax Return), për të ardhurat e përfituara nga A.Q, viti tatimor 2007, në vlerën totale 94.696 Usd.
- Dokumentacion në gjuhën angleze (U.S Individual Income Tax Return), për të ardhurat e përfituara nga A.Q, viti tatimor 2009, në vlerën totale 62.605 Usd.
- Dokumentacion në gjuhën angleze (U.S Individual Income Tax Return), për të ardhurat e përfituara nga A.Q, viti tatimor 2012, në vlerën totale 75.198 Usd.
- Dokumentacion në gjuhën angleze (U.S Individual Income Tax Return), për të ardhurat e përfituara nga A.Q, viti tatimor 2013, në vlerën totale 60.610 Usd.
- Dokumentacion në gjuhën angleze (U.S Individual Income Tax Return), për të ardhurat e përfituara nga A.Q, viti tatimor 2014, në vlerën totale 100.031 Usd.
- Dokumentacion në gjuhën angleze (U.S Individual Income Tax Return), për të ardhurat e përfituara nga A.Q, viti tatimor 2015, në vlerën totale 112.237 Usd.
- Dokumentacion në gjuhën angleze (U.S Individual Income Tax Return), për të ardhurat e përfituara nga A.Q, viti tatimor 2016, në vlerën totale 120.296 Usd.
- Dokumentacion në gjuhën angleze (U.S Individual Income Tax Return), për të ardhurat e përfituara nga A.Q, viti tatimor 2018, në vlerën totale 102.016 Usd.

- Dokumentacion ne gjuhën angleze (U.S Individual Income Tax Return), për te ardhurat e përfituara nga A.Q, viti tatimor 2019, ne vlerën totale 159.119 Usd.
- **ABI Bank**, me shkresën nr. 22/9 prot, datë 08.05.2023, konfirmon se Ermal Muçaj, ka marrë kredi hipotekore në datë 16.05.2006, në vlerën 25.000 euro, me afat maturimi 20 vjeçar. Bashkëkredimarrëse në këtë kredi, rezulton të ketë qenë edhe Benarda Muçaj. Konstatohet se në datën 28.09.2012, subjekti krediton vlerën 22.367 euro, me përshkrimin "*Derdhje për shlyerje totale kredie*", kredi e cila rezulton të jetë mbyllur ne te njëjtën datë.
- 53. Në proces verbalin e datës 18.10.2023, subjekti ka sqaruar se dokumentacioni lidhur me te ardhurat e dorëzuara, i përket vëllait te bashkëshortes shtetasit A.Q, në Shtetet e Bashkuara, pavarësisht se mund të jetë bërë ndonjë lapsus ne shkrimin e emrit. Dokumentacioni për këto të ardhura i është dhënë nga shtetasi A. Qerimani, i cili i ka dhënë hua vlerën 85.000 Usd, me këste, dorazi, deri në vitin 2012, gjatë periudhës që ai vinte herë pas here nga Shtetet e Bashkuara në Shqipëri, si dhe pjesërisht nga babai i tij në Tiranë, me burim te ardhurat e A.s në Amerikë. Kjo hua është përdorur nga ana e tij, për shlyerjen e kredisë për blerjen e apartamentit të parë me sip. 81 m2, për mobilim dhe punime në apartamentin ekzistues, si dhe për shpenzime te ndryshme familjare nder vite.
- 54. Me inventarin e datës 6.11.2023. subjekti ka dorëzuar dokumentacionin si me poshtë:
 - Deklaratë e thjeshte nga M.Q (babai i b/shortes), datë 03.10.2023, i cili deklaron se djali i tij A.Q, punon dhe jeton prej vitesh ne Amerikë, ku përfiton të ardhura të konsiderueshme. Deklaron se djali i tij ka ardhur herë pas here në Shqipëri, ku ka sjellë shuma të ndryshme ne dollarë, të cilat i ka menaxhuar ai si babai i tij. Për nevoja familjare sqaron se me miratimin e djalit të tij i ka dhënë vajzës Benarda, shuma të ndryshme cash në dollarë, me burim të ardhurat e djalit të tij A.Q, për një periudhë deri në fillim të vitit 2012. Këto shuma janë dhënë, siç e ka sqaruar, me miratimin e djalit të tij, pasi ai kishte një marrëveshje me b/shortin e vajzës së tij.
 - ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues, lidhur me huanë e marrë kunatit te tij A.Q, në Amerikë, si dhe qëllimet e përdorimit të saj; shlyeje kredie, arredim dhe punime në apartament, si dhe shpenzime familjare ndër vite.**
 - Llogari kartë krediti master card ne RFZ Bank me limit 1.850 euro dhe me gjendje shumë debitoare. Detyrimi 902 euro.
Bashkëlidhur deklaratës:
 - Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, datë 27.01.2023, për llogari në euro, në emër të Ermal Muçaj, për periudhën 17.01.2022 - 15.12.2022.
 - Raiffeisen Bank, me shkresën nr. 22/2 prot, datë 08.05.2023, konfirmon në emër të Ermal Muçaj, llogari karte krediti Master Card, në euro, me limit ne vlerën 1.850 euro, me gjendje në datë 03.03.2023, ne vlerën -860 euro.

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES - BENARDA MUCAJ
DEKLARIMI I PASURIVE

- Llogari page ne RFZ Bank, me gjendje ne shumë 85.300 lekë. Zotëron 100 %.
- Bashkëlidhur deklaratës:
 - Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, datë 27.01.2023, për llogari në lekë, në emër të Benarda Muçaj, për periudhën 5.1.2022 - 20.12.2022.
 - Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot, date 8.5.2023, konfirmon ne emër te Benarda Muçaj, llogari page në lekë, me gjendje ne datë 03.03.2023, në vlerën 85.264 lekë.

✓ **Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e Raiffeisen Bank.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

Të ardhura nga paga, shpërblime si Oficere ne Gardën e Republikës, për periudhën 05.05.1999 deri në 03.03.2023, shuma rreth 14.908.775 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, për llogari ne lekë, ne emër te Benarda Muçaj, për periudhën 2005 - 2022.
- Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** prot, date 08.05.2023, ka b/lidhur CD te llogarive bankare te Benarda Muçaj, ku konfirmohen kreditimet nga paga, shpërblime dhe dieta, për periudhën 06.05.2005 - 03.03.2023, ne vlerën 13.277.000 lekë.
- ISSH, me shkresën nr. **** prot, date 10.05.2023, konfirmon pagat bruto/neto të Benarda Muçaj, për periudhën janar 2012 - mars 2023, nga Garda e Republikës.
- ✚ Me inventarin e datës 6.11.2023, subjekti ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:
- Vërtetim nga Garda e Republikës, ku vërteton se Benarda Muçaj, për periudhën shkurt 1999-mars 2005, ka përfituar te ardhura neto ne vlerën totale 1.802.883 lekë.
- ✓ ***Te ardhurat e b/shortes nga paga, shpërblime, dieta, etj., për periudhën shkurt 1992 - mars 2023, janë ne vlerën totale rreth 15.080.000 lekë.***

DEKLARIMI I DJALIT - KLEI MUCAJ

DEKLARIMI I PASURIVE

- Automjet tip Volkswagen Golf 5, viti 2004 me targe AA***ZY, në pronësi të Klei Muçaj, me vlerë 1.200 euro, me burim kursimet familjare. Zotëron 100 %.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitje automjeti, datë 28.12.2019, me palë shitëse I. G dhe blerës Klei Muçaj, për shitjen e automjetit tip VË Golf, viti 2005, ne vlerën 1.200 euro.
- Fature tatimore shitje, date 28.12.2019, me shitës I.G dhe blerës Klei Muçaj, për veture VVGolf, viti 2005, vlere e faturës 1.200 euro.
- DPSHTRR, me shkresën nr. 22/27 prot, datë 11.05.2023, konfirmon ne emër të Klei Muçaj, automjetin me targe AA *** ZY, tip VV Golf, viti 2005, blerë sipas kontratës së shitblerjes datë 28.12.2019, ne vlerën 1.200 euro. B/lidhur praktika.
- DPSHTRR, me e-mailin e datës 07.06.2023, ka b/lidhur dokumentacionin për automjetin me targe AA *** ZY, tip VV Golf, viti 2005, blerë nga Klei Muçaj, sipas faturës tatimore të datës 28.12.2019, si dhe kontratës së shitblerjes, datë 28.12.2019, në vlerën 1.200 euro.
- ✓ ***Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.***

55. Ne Deklaratën e Pasurisë për vlerësim kalimtar, Ermal Muçaj ka deklaruar adresën e plotë ku është regjistruar në Gjendje Civile: Njësia Administrative nr. 6, rruga "LL.M", Tiranë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë familjare, date 15.11.2021, lëshuar nga Njësia Administrative nr. 6, Tirane, ne emër të Ermal, Benarda, Klei, Erik dhe Ergi Muçaj.
- ✚ ***Ne proces verbalin e datës 18.10.2023. Subjekti ka dhënë sqarime ne lidhje me adresën e deklaruar si me sipër, e cila i përket adresës së Njesisë Administrative nr.***

6, Tiranë, ku është i regjistruar në gjendjen civile, pasi aty ka qenë banesa e prindërve të tij, që e kanë përfituar këtë apartament me kontribut vullnetar përpara viteve 1990. Sqaron se adresa e tij aktuale e banimit është në rrugën "P.K", Tiranë, e cila me parë ka qenë emërtuar rruga "Ibrahim Dervishi "dhe më parë rruga "I.T", konkretisht ne apartamentin e deklaruar nga ana e tij.

- ✓ Subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me adresën e deklaruar si me sipër.

KONTROLLI I FIGURËS

56. Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

57. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre elementë:

- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
- Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
- Verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, gërma (ë), e ligjit 12/2018, i ndryshuar.

58. Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit Z. Ermal Petrit Muçaj, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikimit nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

59. Për kontrollin e figurës Trupa e Vlerësimit administroi:

- a. Deklaratën e "Kontrollit të Figurës".
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore administruar pranë trupës më datë 04.10.2023 me shkresën nr.*** prot datë 03.10.2023.

60. Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:

- Të dhënat e paraqitura në Deklaratën për Kontrollin e Figurës janë të sakta dhe të vërteta.

- Është i vetëdijshëm se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës për kontrollin e figurës mund të sjell përjashtimin nga detyra, sipas ligjit “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Mbikqyrjes Policore”, të ndryshuar.

61. Formulari i deklaramentit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit Nr. 12/2018, i ndryshuar. Pas shqyrtimit paraprak të formularit të deklaramentit u vendos dërgimi i kërkesës për verifikim të kontrollit të figurës në Drejtorinë e Analizës dhe Kartotekës referuar nenit 42 të ligjit 12/2018 i ndryshuar.

Hetimi administrativ

Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaramentit të subjektin e vlerësimit lidhur me këtë aspekt, janë kryer veprime duke kërkuar të dhëna nga institucionet të shprehura në ligj, referuar nenit 37 të ligjit 12/2018 i ndryshuar.

Nga informacionet e dërguara nga institucionet e mësipërme konstatohet se:

1. **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile** me shkresën “I Kufizuar” me nr prot.*** datë 25.05.2023, konfirmon se nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve apo lënie marrje shtetësie.
2. **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**, me shkresën “I Kufizuar” datë 19.05.2023, konfirmon se nuk rezulton i dënuar.
3. **Institucion Ligjzbatues**, me shkresën “Sekret” datë 30.03.2023, konfirmon se nuk disponon të dhëna.
4. **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit**, me shkresën “I Kufizuar” datë 26.05.2023; shkresën “Pa Klasifikuar” datë 30.05.2023; shkresën “Sekret” datë 31.07.2023, fotokopje e shkresës “Sekret” nr.*** datë 20.07.2023 drejtuar Avokatit të Popullit dhe fotokopje e shkresës nr.*** datë 24.07.2023, konfirmon se për subjektin e vlerësimit Z. Ermal Petrit Mucaj, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare:
 - a. Nuk ka të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
 - b. Nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, (sipas përcaktimeve të bera në ligjin Nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar") ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj;
 - c. Nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar);
 - d. Nuk ka të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një veprë penale;
 - e. Nuk ka të dhëna nëse ka qënë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një veprë penale;

- f. Nuk ka të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhëri ndërkombëtar, për kryerjen e nje vepre penale;
 - g. Nuk ka të dhëna në lidhje me ndonje masë dëbimi nga një shtet i huaj;
 - h. Nuk ka të dhëna nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonje shtet të BE/NATOS-
 - i. Nuk ka të dhëna nëse nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet,
 - j. Nisur nga gjetjet, konstatimet dhe rekomandimet e Drejtorisë së Standarteve Profesionale, për moskoordinim dhe bashkëpunimin e duhur të strukturave të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë me institucionin e Avokatit të Popullit, në zbatim të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr.750, datë 16.09.2015 (e ndryshuar), neni 237, pika 3, Drejtorit të DVP Vlorë Drejtues Ermal Muçaj i është dhënë "Tërheqje vëmendje".
5. **AISM** me shkresën nr.*** datë 31.05.2023 konfirmon se nuk disponon të dhëna.
 6. **Organ Ligjzbatues** me shkresën "I Kufizuar" nr.***, datë 27.06.2023 , konfirmon se:
 - a. Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi;
 - b. Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal;
 - c. Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
 - d. Nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale;
 - e. Nuk ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.
 7. **Nga një institucion tjetër lig zbatues** me shkresën "I kufizuar" nr. *** prot., datë 01.06.2023 bën me dije se nuk rezulton të jetë regjistruar procedim penal.
 8. **Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave**, me shkresën nr.*** datë 19.05.2023, konfirmon se ka raportime financiare rutinë për subjektin dhe bashkëshorten e tij.
 9. **Organ ligjzbatues**, i cili me shkresën "I Kufizuar" me nr. ***, datë 19.05.2023, konfirmon se subjekti është i pajisur me certifikatë sigurie "Tepër Sekret" të vlefshme deri më 26.08.2026 si dhe nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror", të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.
 10. **Avokati i Popullit**, për subjektin e vlerësimit Ermal Muçaj, me detyrë Drejtor në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, rezulton se gjatë periudhës kohore që ky punonjës policie kryen kate detyrë, nuk ka bashkëpunuar me institucionin e Avokatit të Popullit, për shqyrtimin me objektivitet dhe profesionalizëm të ankesës së shtetasit B. L, i cili ka kandiduar për t'u punësuar në Gardën e Republikës dhe pas konkurrimit është shpallur fitues. Pas shpalljes së rezultateve të konkurrimit ai është skualifikuar, duke mos u pranuar në strukturat e Gardës së Republikës, sepse vërtetimi i besueshmërisë së tij është bërë negativ nga Komisariati i Policisë Vlorë. D.V.P Vlorë, refuzoi të vinte në dispozicion dokumentet në ngarkim të shtetasit B.L. *Në bazë të nenit 22/1 "Sanksionet për mosbashkëpunimin me Avokatin e Popullit", të Ligjit organit "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, është kërkuar fillimi i procedurës administrative ndaj drejtorit të D.V.P Vlorë z. Ermal Muçaj.*
 11. **Agjencia e Mbikëqyrjes Policore**, bën me dije se:
 - a. Nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundërligjshëm;
 - b. Nuk ka procedime penale të referuara;

- c. Për subjektin e vlerësimit Ermal Muçaj, në Sistemin e Menaxhimit të Ankesave, është regjistruar Raportimi i Komisarariatit Dixhital, në të cilin jepet informacion për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, në drejtim të lejimit të lojërave të fatit dhe shpërndarjes së lëndëve narkotike, nga punonjës të Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë, përfshirë dhe Ermal Muçaj, në atë kohë Zv/drejtor i D.V.P Korçë.
62. Denoncimi është trajtuar nga Drejtoria Rajonale e AMP-së Elbasan –Korçë, dhe ka rezultuar se informacioni ka qënë i paplotë dhe i pabazuar në prova e fakte.

63. Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38, të Ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se: **nuk u zbulua** prania e produkteve të metabolizmit të MOP (opiate/heroine), COC (kokaine), MTD (metadon), THC (canabioide/cannabis sativa), BARB (barbiturate), TCA (triciklike antidepressantë, AMP (amfetaminë), MDMA (ekstazi), LSD (acid lisergjik), BZO (benzodiazepina).

Në përfundim të veprimtarisë verifikuese të kryer në përputhje me ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, Trupa e Vlerësimit bazuar në parimin e kontradiktoritetit u mbështetet edhe në shpjegimet që dha subjekti i vlerësimit pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancë dëgjimore.

VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

64. Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.
65. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit nr.12/2018, i ndryshuar,
 - Raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standardet profesionale në Policinë e Shtetit/Gardën e Republikës/Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.
66. Subjekti i vlerësimit Z. Ermal Muçaj, në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë, Vlorë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë të Shtetit.
67. Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të vlerësimit mbështetet në informacionin dhe dokumentacionin e marrë nga DPPSH, në dokumentacionin e paraqitur nga

subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ kryesisht si dhe nga burime të tjera të ligjshme për nivelin e arsimit në përputhje me pozicionin e punës. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e vlerësimit, është kryer në përputhje me kreun V, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të Ligjit nr.12/2018, (i ndryshuar) bazuar në nenet 43 - 46, të po këtij ligji.

68. Ermal Muçaj, është subjekt i vlerësimit të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar dhe aktualisht mban detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë, Vlorë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë të Shtetit, bazuar në urdhrin e emërimit, nr. ***, datë 25.07.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

69. Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale sipas përcaktimit të nenit 43, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka të bëjë me vlerësimin e nivelit të arsimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin, respektimin e rregullave të etikës, si dhe përmbushjes së detyrave nga subjekti në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e Policisë së Shtetit.

70. Procedura për vlerësimin e aftësive profesionale kryhet bazuar në nenet 44-46, duke mbajtur në vëmendje aftësitë profesionale dhe ecurinë në karrierë të punonjësit duke respektuar legjislacionin e posaçëm që rregullon marrëdhënien e punës (në këtë rast Ligji për Policinë e Shtetit, Rregullorja e Policisë dhe aktet e tjera rregullatorë e nënligjore në fuqi) si dhe në përshkrimet e punës për çdo funksion.

71. Trupa Vlerësuese përdori si burime për vlerësimin e saj, fillimisht :

- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e Aftësive Profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

- Më tej, të dhënat nga institucionet përgjegjëse që konfirmojnë nivelin arsimor dhe kualifikimet përkatëse, ecurinë në karrierë të subjektit nga dosja e personelit dhe nga vërtetime e akte të tjera administrative të emërimeve në funksione dhe dhënies së gradave respektive, ecurinë disiplinore, vendimet e formës së prerë të gjykatave që lidhen me procese disiplinore etj. Vlerësimet e punës individuale në pesë vitet e fundit. Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit mban në konsideratë dhe shqyrton edhe denoncimet nga publiku për sjellje jo profesionale të punonjësit, apo informacione të tjera të lidhura me ushtrimin e detyrës së tij në mënyrë jo etike.

- Afati kohor brenda të cilit shtrihet procesi i vlerësimit të aftësive profesionale.

72. Subjekti i vlerësimit Ermal Muçaj ka dorëzuar në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, (Formularin e Vetëvlerësimit të Aftësive Profesionale), sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të Ligjit Nr. 12/2018, të ndryshuar. Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet.

73. Vlerësimi i nivelit arsimor:

Në formularin e Aftësive Profesionale për Vlerësimin Kalimtar subjekti ka deklaruar:

- ✓ Akademia e Policisë 1994-1997 cikli 3 vjeçar Tiranë. Diplomë me nr. Regjistri *** datë 03.07.1993.
- ✓ Fakulteti i Drejtësisë Universiteti Eësdom 2013.
- ✓ Diplomë master profesional.
- ✓ Subjekti i Vlerësimit ka kryer dhe një sërë kursesh e trajnimesh për ngritjen e tij profesionale.

- Të dhënat janë të administruara në dosjen personale të subjektit të vlerësimit me nr. ***.
- Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Sistemi RMIS me numër ***.
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në Formularin e Aftësive Profesionale për Vlerësimin Kalimtar.
- Të dhënat e siguruara nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi Performancën e Subjektit.
- Të dhënat e siguruara nga burimet e mësipërme, konfirmojnë nivelin arsimor, ecurinë në karrierë dhe gradë, trajnimet, kualifikimet dhe vlerësimet individuale të punës si edhe performancën e konstatuar gjatë kontrolleve dhe inspektimeve apo ankesave në drejtim të subjektit nga Drejtoria e Standardeve Profesionale apo institucionet e tjera mbikëqyrëse.

Niveli arsimi	Institucioni ku janë ndjekur studimet	Fillimi	Përfundim	Vendi	Titulli/ Diploma
3-vjecare	Akademia Policisë	1994	1997	Tiranë	Diplomë
Bachelor	Shkolla e Lartë Universitare jopublike “Wisdom”	2012	2013	Tiranë	Diplomë
Master Profesional	Fakulteti Ismail Qemali Vlorë	2017	2022	Tiranë	Diplomë

❖ Arsyetimi ligjor i Trupës Vlerësuese:

Në kuptim të legjislacionit për Policinë e Shtetit dhe në ligjin në fuqi Nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, trupa e vlerësimit arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, që në kohën e emërimit në detyrë për herë të parë në Policinë e Shtetit dhe deri në vijueshmërinë e ecursë në karrierë të tij, ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor.

Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit të vlerësimit rezulton se subjekti ka kryer edhe trajnime dhe specializime dhe për këtë ka marrë edhe certifikatat përkatëse. Ai u ka kushtuar rëndësi trajnimeve që kanë të bëjnë me objektin e tij të punës si dhe ka marrë pjesë në konferenca dhe Ëorkshop-e të ndryshëm.

Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit, rezulton se ai ka kryer trajnimet/specializimet si më poshtë:

Nr/Viti		Emërtimi i trajnimit	Lloji i Dokumentit
1.	2000	Kurs Kompjuteri.	Certifikatë
2.	2000	Trajnim me Zyrën e Antiterrorit Turk ne Elbasan .	Certifikatë
3.	2002	Trajnim me Dep.Amerikan të Shtetit mbi Korrupsionin dhe Policinë.	Certifikatë
4.	2003	Kurs mbi hetimin e vrasjeve me Icitap dhe Dep.of Justice.	Certifikatë
5.	2007	Kurs trainimi per OPGJ me UNCRI dhe shkollen e magjistratures.	Certifikatë
6.	2009	Trajnim mbi krimet financiare organizuar Guardia di Finanza	Certifikatë

7.	2014	Trajnim dyjavore në shkollën e magjistratures për OPGJ të Prok Krimeve të rënda	Certifikatë
8.	2014	Trajnim ne Slloveni per Lidershipin.	Certifikatë
9.	2017	Kurs njëjavor per hetimin e krimeve " nga Dep Drejtesise dhe ICITAP.	Certifikatë
10.	2017	Certifikate trainimi "Per informim dhe Privacy ".	Certifikatë

Në dosjen personale të subjektit për periudhën 2018-2023 rezulton se janë administruar 3 (tre) vlerësime pune, dy mungojnë.

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore ka kërkuar të dhëna shtesë DPPSH, për procesin e vlerësimit kalimtar për subjekti z. Emal Muçaj.

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me shkresën konfirmon se për subjektin e vlerësimit Z. Ermal Muçaj në lidhje me vlerësimin e punës për periudhën 2020 dhe 2021 nuk ka të administruar në dosje vlerësim pune për këtë periudhë.

Për periudhën 2018-2022 është vlerësuar si vijon:

- a. Vlerësim i rezultateve të punës për vitin 2018 27 pikë (shumë mirë)
- b. Vlerësim i rezultateve të punës për vitin 2019 27 pikë (shumë mirë)
- c. Vlerësim i rezultateve të punës për vitin 2020 ska
- d. Vlerësim i rezultateve të punës për vitin 2021 ska
- e. Vlerësim i rezultateve të punës për vitin 2022 98 pikë (shumë mirë)

Për periudhën e fundit 5(pesë) vjeçare 2018-2023 të përcaktuar në pikën 2, të nenit 44, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar subjekti i vlerësimit është ndëshkuar me masë disiplinore “Tërheqje Vëmendje”.

❖ **Konkluzion i Trupës Vlerësuese:**

Bazuar në vlerësimet e mësipërme trupa vlerësuese arrin në konkluzion se subjekti i vlerësimit ka përmbushur detyrat funksionale, respektuar rregullat e etikës si edhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.

Konkretisht:

- ✓ 28.04.2017-31.08.2020: Përgjegjës i Departamentit ai Zv/drejtor i Policimit në Patrulle, në Akademinë e Sigurisë.
- ✓ 01.09.2020-18.10.2021: Drejtor i Qendrës së Mbyllur të të Huajve.
- ✓ 19.10.2021 – 16.12.2022: Zv/Drejtor për Hetimin e Krimeve DVP Korçë.
- ✓ 17.12.2022 e në Vazhdim: Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë.

74. Ecuria në Gradë e Subjektit të Vlerësimit Z. Ermal Muçaj :

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.1755/4 dt.30.12.2014, “Për ngritje në gradë të një punonjësi policie “K/Komisar” z. Ermal Muçaj i cili është shpalluar fitues në konkurimin për gradën policore “Drejtues”, përfundon kursin e barasvlershëm/ekuivalent me shkollimin për nivelin e mesëm drejtues, i jepet grada policore “Drejtues”, Gradë të cilën e mban dhe aktualisht.

❖ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese pranë AMP:**

75. Nga shqyrtimit i dokumentacionit në dosjen e subjektit me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 1755/4 datë 30.12.2014 “Për ngritje në gradë të një punonjësi policie” bazuar në nenin 42 pika 1 dhe 2, shkronja “b” e ligjit nr. 9749 datë 04.06.2007, “K/Komisar” Ermal Muçaj pasi ka përfunduar kursin e trajnimit për gradë, i jepet grada policore “Drejtues”, Gradë të cilën e mban dhe aktualisht.

Emërtimi Gradës	Arsyeja e ndryshimit	Nr. Urdhrit	Data	
				Deri
Drejtues	Ngritur në gradë	Nr.1755/4 dt.30.12.2014	30.12.2014	aktualisht

❖ **Konkluzioni Trupës Vlerësuese:**

Në përfundim, në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të Subjektit të Vlerësimit, trupa vlerësuese arrin në konkluzion se funksionet në të cilat është emëruar subjekti si edhe gradat që ai ka përfituar gjatë karrierës së tij rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Në përfundim të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit Z. Ermal Muçaj, bazuar në të dhënat e disponueshme të administruara në dosjen personale, sistemin RMIS, si dhe deklaratimet e vetë subjektit në dokumentacionin e dorëzuar në momentin e deklaratimit, në mbështetje të nenit 47, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, arrijmë në përfundimin se:

Subjekti i Vlerësimit Z. Ermal Muçaj është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme duke rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar funksionin që mban.

KONKLuzioni Përfundimtar

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin e relatores së çështjes, shpjegimet me shkrim të dhëna nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe pasi u njoh me qëndrimin e subjektit të vlerësimit në seancën dëgjimore publike të datës 12.04.2024, ftoi subjektin në seancën e dhënies së vendimit të datës 15.04.2024, arrin në përfundimin se subjekti i vlerësimit **Ermal Muçaj** në përputhje me nenin 60 të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë,
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës,
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit e Agjencise se Mbikqyrjes Policore , bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të ligjit nr. 12/2018 (të ndryshuar)

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit **Z.Ermal Petrit Muçaj, me funksion Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.**
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, (të ndryshuar).
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, sot datë 15.04.2024.

TRUPA E VLERËSIMIT

Arben Sefaj

Kryesues

Denisa Sina

Relator

Suela Bulku

Anëtar

